

Programi Përgatitor për Specialist Themelor të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Kompania Bliterm, e licencuar nga **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**, ofron programin profesional për **Specialist Themelor të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP)** – një trajnim bazik, i domosdoshëm për të gjithë personat që synojnë të kryejnë detyra në fushën e SSHP në kompani me risk të ulët.

Programi është hartuar për të ofruar njohuri praktike dhe të aplikueshme, duke përmbushur standardet dhe kërkesat ligjore të përcaktuara për këtë nivel profesional.

Qëllimi i Programit

Programi synon të:

- Pajisë pjesëmarrësit me **bazën e njohurive ligjore dhe teknike** për menaxhimin e çështjeve të sigurisë në vendet e punës me risk të ulët;
- Mundësojë aftësi praktike për identifikimin e rreziqeve, ndërmarrjen e masave parandaluese dhe raportimin korrekt;
- Përgatisë kandidatë që mund të mbështesin punëdhënësin në organizimin dhe dokumentimin e sistemit themelor të SSHP;
- Ofron kompetenca të mjaftueshme për të asistuar në proceset bazike të vlerësimit të riskut, monitorimit dhe njoftimit të punëtorëve.

Pas certifikimit, kandidati mund të angazhohet si **Specialist Themelor i SSHP në kompani me risk të ulët deri në 50 punëtorë**, duke përmbushur detyrat fillestare të menaxhimit të sigurisë.

Kushtet e Pranimit

Për t'u regjistruar në program, kandidati duhet të ketë:

- **Arsim të mesëm**, ose
 - **Arsim universitar**
-

Modulet e Programit

Programi përfshin këto module përgatitore:

- **Sistemi themelor i SSHP dhe kërkesat ligjore**

Roli i punëdhënësit, punëmarrësit, dokumentacioni minimal, mbikëqyrja shtetërore dhe strukturat përgjegjëse.

- **Faktorët e riskut në vendin e punës**

Llojet e rreziqeve: fizikë, kimikë, ergonomikë, biologjikë, psikologjikë dhe traumatik.

- **Parandalimi i faktorëve të riskut**

Masat teknike, organizative dhe administrative që aplikohen në kompani me risk të ulët.

- **Vlerësimi i riskut në vendin e punës**

Hapat e vlerësimit, identifikimi i rreziqeve dhe përdorimi i formave bazike të dokumentimit.

- **Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale**

Raportimi, shkaqet e shpeshta, dokumentimi dhe masat pas ngjarjes.

- **Ndihma e parë dhe planifikimi i emergjencave**

Organizimi minimal i ndihmës së parë, evakuimi dhe reagimi fillestar.

- **Marrëdhëniet ligjore të punës**

Obligimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, rregulloret e brendshme dhe komunikimi formal.

- **Puna praktike**

Shembuj konkretë, ushtrime dhe situata reale të aplikimit të njohurive.

Metodologjia e Trajnimit

Trajnimi zhvillohet përmes:

- Ligjëratave të strukturuar
- Diskutimeve dhe ushtrimeve praktike
- Shembujve dhe rasteve nga terreni
- Përgatitjes për testimin përfundimtar

Pas përfundimit të trajnimit mbahet **testi përfundimtar**, dhe pas kalimit të testit lëshohet **Certifikata e Specialistit Themelor të SSHP**.

Kohëzgjatja dhe Organizimi

- **Orari:** çdo të Enjte
- **Fondi i orëve:** 60 orë mësimore (40 orë teori + 20 orë praktik)
- **Lokacioni:** Prishtinë

APLIKO TANI: _____